

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Kosovë

Raport vjetor 2019

1 janar - 31 dhjetor 2019

**Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut – Sekretariati
Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë**

Tel: +383 (0) 38 28 2207

Email: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Parathënie

Ky është raporti vjetor i dhjetë i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli" ose "PShDNj-ja"), i cili mbulon periudhën nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2019. Raporti është përgatitur dhe i është paraqitur Misionit, shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve kontribuuese të treta, si dhe publikut me qëllim të informimit rreth zhvillimit të praktikës gjyqësore dhe aktiviteteve të Panelit.

Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka mbajtur pesë seanca dhe ka marrë njëzet e një (21) vendime në gjashtëmbëdhjetë (16) lëndë.

Një mandat i ri dhe i rishikuar për EULEX-in Kosovë u miratua me Vendimin e Këshillit CFSP 2018/856 më 8 qershor 2018. Ai hyri në fuqi më 15 qershor 2018. Sipas këtij mandati të ri, EULEX-i Kosovë kryen monitorim sistematik, tematik dhe ad hoc. Ai ofron vlerësimet dhe gjetjet e tij për institucionet e Kosovës dhe mban të informuar akterët e tjerë të rëndësishëm të BE-së për këto aktivitete. Ai gjithashtu mban një numër të vogël të kompetencave ekzekutive në mbrojtjen e dëshmitarëve, inteligjencës kriminale dhe mirëmbajtjen e rendit publik si reagues i dytë i policisë së Kosovës.

Ndryshimi në mandatin e EULEX-it Kosovë, i cili në masë të madhe zvogëloi fushën e përgjegjësive të tij ekzekutive, ndikoi në punën e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si pasojë dhe të reflektuar ndryshimet përkatëse në Mision, më 15 janar 2019, Paneli ndryshoi Rregulloren e tij të Punës për të reflektuar ndryshimin e mandati të Misionit dhe efektin e tij në përbërjen e Panelit. Rregullorja e Punës së Panelit u ndryshua përsëri në 11 dhjetor 2019 si përgjigje ndaj një çështje që u ngrit në një rast.

Gjatë vitit, pati ndryshime edhe në përbërjen e Panelit. Me 13 dhjetor 2018, znj. Magda Mierzevska dha dorëheqjen nga pozita e saj si anëtare e Panelit. Një proces i rekrutimit dhe përzgjedhjes ndërkombëtare u hap nga Misioni për të identifikuar zëvendësimin. Më 26 qershor 2019, znj. Anna Autio nga Finlanda u emërua nga shefi i Misionit. Me plotësimin e Panelit tani, më 11 shtator 2019, z. Guénaël Mettraux u zgjodh zyrtarisht kryesues i Panelit.

Për fat të keq, procesi i zëvendësimit të anëtarëve të Panelit dhe ndryshimi në mandatin e Misionit shkaktuan vonesa në përpunimin e lëndëve në Panel dhe ndikuan në numrin e lëndëve të trajtuara gjatë asaj periudhe.

Në vitin 2019, janë regjistruar dy (2) ankesa të reja dhe katër (4) raste kanë përfunduar, nga të cilat tre (3) janë shpallur të papranueshme. Rasti i katërt që ishte përfunduar kishte të bënte me vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të Panelit për shefin e Misionit, pas së cilës u vendos që të mbyllet shqyrtimi i lëndës.

Deri më 31 dhjetori 2019, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e pesë raste. Nga këto, pesë (5) raste kur ishte konstatuar shkelje mbeten të hapura dhe i nënshtrohen vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve të Panelit nga shefi i Misionit.

Nga njëzet e pesë (25) raste në pritje, njëzet e një (21) kanë të bëjnë me rastet e zhdukjeve me forcë gjatë dhe pas konfliktit të Kosovës 1998-1999. Të gjitha këto raste fillimisht iu komunikuan shefit të Misionit të EULEX-it në dhjetor 2017. Asnjë përparim nuk është arritur në këto raste gjatë vitit 2018 në një pjesë të madhe për shkak të rikonfigurimit të Misionit. Gjatë vitit 2019, përgjigjet nga shefi i Misionit janë paraqitur në katërmëdhjetë (14) nga këto raste. Në fund të vitit, që la edhe shtatë (7) raste të zhdukjeve me forcë që ende prisnin një përgjigje të parë nga shefi i Misionit. Prosesi më vonë u përshpejtua dhe parashtresat u bënë dhe vazhduan të bëhen në rastet e mbetura pas shqyrtimit të gjerë të dosjeve të tij nga Misioni.

Paneli pret që shumë prej lëndëve në pritje do të trajtohen gjatë vitit 2020 dhe fillimit të vitit 2021.

Rastet e zhdukjes me forcë do të përbëjnë pjesën më të madhe të numrit të lëndëve. Paneli është më i shqetësuar se lëndët që datojnë nga fundi i viteve 1990 mbeten, në shumë raste, plotësisht të pa hetuara. Për shkak të kufizimeve të reja të vendosura në mandatin e tij, Misioni nuk mund të fillojë hetimin e këtyre rasteve. As nuk ka shumë gjëra që mund të bëjnë për t'i nxitur të tjerët ta bëjnë këtë. Prandaj ekziston një rrezik i vërtetë që shkeljet e të drejtave të njeriut me peshë ekstreme mund të mbeten të pa hetuara dhe viktimat do të mbeten pa të vërtetën, drejtësinë dhe mjetin efektiv juridik. Paneli u bën thirrje autoriteteve përkatëse politike, përfshirë vetë Misionit, shteteve anëtare, shteteve kontribuese dhe autoriteteve vendore që ta shqyrtojnë këtë çështje më me kujdes për të siguruar që lëndët të hetohen dhe që viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut të jenë në gjendje të marrin kompensim adekuat.

Siç bëri në Raportin vjetor të vitit 2018, Paneli gjithashtu do të ftojë Misionin të konsiderojë nevojën për krijimin e një sistemi të dëmshpërblimit për individët, të drejtat e të cilëve janë gjetur se janë shkelur nga Misioni. Është me të vërtetë e rëndësishme që shkelja e të drejtave të tyre nuk duhet që thjeshtë vetëm të njihet nga Paneli, por që Misioni duhet të përpiqet të rregullojë dëmet e bëra ndaj tyre si pasojë e atyre shkeljeve.

Guénaél Mettraux

Kryesues

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
1. Korniza rregullative.....	5
1.1. Veprimi i Këshillit 2008/856 i datës 8 qershor 2008.....	5
1.2. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë.....	5
1.3. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009.....	5
1.4. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut	6
1.5. Rregullorja e punës	6
2. Numri i rasteve dhe lënda e ankesave.....	6
2.1. Numri i rasteve dhe statistikave.....	6
2.2. Subjekti i ankesave.....	7
2.3. Seancat e Panelit.....	8
3. Jurisprudenca.....	8
3.1. Hyrje.....	8
3.2. Vendimet për meritat	8
3.3. Vendimet e pranueshmërisë.....	9
3.4. Vendimet pasuese.....	11
4. Aktivitetet e tjera të Panelit	13
4.1. Takimet	13
4.2. Fushata informuese e vitit 2019	13
4.3. Trajnimi hyrës	13
4.4. Faqja e internetit e PShDNJ-së	14
5. Paneli dhe Sekretariati.....	14
5.1. Anëtarët e Panelit	14
5.1.1. Kryesuesi i Panelit	14
5.1.2. Anëtarët deri më 31 dhjetor 2019.....	15
5.2. Sekretariati.....	17
6. Çështjet operative dhe administrative	17
6.1. Buxheti	17
6.2. Burimet njerëzore	17
7. Konkluzionet dhe rekomandimet	17
7.1. Pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i.....	17
7.2. Programi i reparacionit	17
7.3. Rastet e personave të zhdukur	18
7.4. Fundi i Misionit dhe të drejtat e njeriut.....	19
SHTOJCA 1 Statistikat 2010 – 2019	20

1. Korniza rregullative

1.1. Veprimi i Këshillit 2008/856 i datës 8 qershor 2008

Në mandatin e tij aktual, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit CFSP 2018/856, EULEX-i Kosovë monitoron lëndët dhe seancat gjyqësore të përzgjedhura në institucionet penale dhe civile të Kosovës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në lëndët që i janë dorëzuar institucioneve kompetente të Kosovës. Për më tepër, EULEX-i Kosovë mban një numër të kufizuar të kompetencave ekzekutive, ndër të tjera, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, inteligjencën kriminale dhe mirëmbajtjen e rendit publik, si reagues i dytë nga autoritetet vendore.

1.2. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë

Veprimi i përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencave të Misionit EULEX-i Kosovë. Në atë veprim përcaktohet *mandati* i EULEX-it Kosovë dhe, ndër të tjera, specifikohet përgjegjësia e tij për të vepruar në përputhje me standardet përkatëse për të drejtat e njeriut, neni 3 (i): *“të sigurojë që të gjitha aktivitetet e tij t’i respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe përfshirjen gjinore”*.

1.3. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Themelimi i një mekanizmi të pavarur, efektiv dhe transparent për llogaridhënie në lidhje me të drejtat e njeriut ishte konsideruar të jetë kriter themelor për EULEX-in Kosovë si mision për sundim të ligjit me disa funksione ekzekutive të kufizuara. Ky mekanizëm i jashtëm i llogaridhënies kishte për qëllim ta plotësonte llogaridhënien e përgjithshme të Misionit EULEX-i Kosovë, siç parashihet me Skemën e Sigurimit të Përgjegjësisë për Palën e Tretë dhe Mekanizmin e Brendshëm Disiplinor të EULEX-it.

Andaj, Koncepti i llogaridhënies përcaktoi *mandatin* e Panelit që: *të shqyrtojë ankesa nga çdo person, që nuk është pjesë e personelit të EULEX-it Kosovë, që pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë*.¹

Megjithatë, sipas Konceptit të llogaridhënies, Paneli nuk ka juridiksion në lidhje në gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it janë anëtarë të trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

¹ Koncepti i llogaridhënies është pjesë e planit operacional të EULEX-it. Ai është dokument i kufizuar dhe nuk është i qasshëm për publikun. Paneli nuk e ka lirinë për zbulimin e detajeve që përmbahen aty.

Paneli e ka miratuar rregulloren e punës së vet më 10 qershor 2010, ku pas kësaj date Paneli është autorizuar të pranojë ankesa. Paneli i ka ndryshuar rregullat e veta më 21 nëntor 2011 dhe 15 janar 2013, 15 janar 2019 dhe prapë më 11 dhjetor 2019.

1.4. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Në pajtim me dispozitat e Konceptit të llogaridhënies, Paneli mund të shqyrtojë ankesa në lidhje me pretendimet e shkeljeve, në mes të tjerash, të instrumenteve të të drejtave të njeriut si në vijim:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MDCP, 1966)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (MDESK, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave (KEFDF, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtitimit apo Dënimit tjetër Mizer, Çnjerëzor apo Poshtëruar (KKT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (KDF, 1989)

Në praktikë, ankesat që janë paraqitur deri më sot kryesisht janë bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj. Një numër i ankesave po ashtu i janë referuar Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut. Referenca u bënë gjithashtu në një numër rastesh për praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut, Konventat e Gjenevës dhe Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

1.5. Rregullorja e punës

Si pasojë e hyrjes në fuqi më 15 qershor 2018 të Vendimit të Këshillit CFSP 2018/856, mandati dhe përbërja e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut u ndryshua gjithashtu. Për të pasqyruar këto ndryshime, Rregullorja e Procedurës duhej të ndryshohej.

Më 15 Janar 2019, Paneli miratoi Rregulloren e tij të ndryshuar të Procedurës për të arsyetuar ndryshimin e mandatit të Misionit dhe nevojën për të rikompozuar Panelin.

Më 11 dhjetor 2019, Paneli miratoi një amendament në rregullin 43 të Rregullores së punës, për të lejuar që të dy palët në një ankesë të jenë në gjendje të paraqesin një kërkesë për rishikimin e gjetjeve të një vendimi të Panelit, në rrethana kur informacioni i ri kishte dalë në dritë, e që nuk ishte në dispozicion në kohën kur Paneli kishte marrë vendimin e tij fillestar.

Rregullorja e Procedurës është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në faqen e internetit të Panelit, në <https://hrrp.eu/reference-documents.php>.

2. Numri i rasteve dhe lënda e ankesave

2.1. Numri i rasteve dhe statistikat



Paneli ka pranuar dy (2) ankesa të reja në vitin 2019.

Paneli ka përfunduar katër (4) raste dhe ka konstatuar se tre (3) prej tyre ishin të papranueshme, ndërsa lënda e katërt u pasua me lëndë pasuese dhe u mbyll.

Paneli ka shpallur dhjetë (10) raste të pranueshme dhe gjeti se Misioni kishte shkelur të drejtat e njeriut të ankuesve në katër (4) raste.

Edhe tre (3) vendime pasuese u miratuan në dy (2) raste, ku Paneli vazhdon të vlerësojë zbatimin e rekomandimeve të tij.

Numri i lëndëve në pritje më 31 dhjetor 2019 ishte njëzet e pesë (25) lëndë.



2.2. Subjekti i ankesave

Ankesat të cilat u morën në shqyrtim nga Paneli në vitin 2019 kryesisht kishin të bënin me raste të zhdukjeve me forcë, të cilat kanë ndodhur gjatë ose menjëherë pas konfliktit 1998-1999 në Kosovë. Ankesat kanë të bëjnë veçanërisht me shkeljet e pretenduara të së drejtës së jetës nën pjesën e saj procedurale, dhe të drejtën për mos t'iu nënshtruar torturave, trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës si rezultat i vuajtjeve të shkaktuara nga zhdukja dhe mungesa e një hetimi efektiv, siç garantohet nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

Një numër i ankesave të paraqitura në vitin 2018 kanë të bëjnë me mandatin e monitorimit të Misionit, si rezultat i ndryshimit të mandatit të EULEX-it Kosovë.

2.3. Seancat e Panelit

Gjatë vitit 2019, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur pesë seanca:

- Seanca e 39-të: 14, 15 dhe 16 janar 2019;
- Seanca e 40-të: 27, 28 dhe 29 mars 2019;
- Seanca e 41-të: 19 dhe 20 qershor 2019;
- Seanca e 42-të: 10, 11 dhe 12 shtator 2019; dhe
- Seanca e 43-të: 11, 12 dhe 13 dhjetor 2019.

3. Jurisprudenca

3.1. Hyrje

Paneli vazhdoi me zhvillimin e juridiksionit të tij dhe nxori një numër vendimesh rreth meritave dhe pranueshmërinë gjatë periudhës raportuese.

Duke vepruar kështu, Paneli u mbështet gjerësisht në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ), jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), por gjithashtu nxori mësim nga instrumente të tjera, përfshirë Konventat e Gjenevës të vitit 1949, Konventa Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (dhe çështja e lidhur me të), Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, jurisprudencën e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, çështjen gjyqësore të vet, si dhe ligjin në fuqi në Kosovë në shqyrtimin e ankesave të tij gjatë periudhës së raportimit.

Për më tepër, Paneli nxori një numër vendimesh për përcjelljen e vendimeve të mëparshme në lidhje me meritat. Aftësia e Panelit për të ndjekur rekomandimet e tij është një element i rëndësishëm i infrastrukturës normative të tij, për aq sa i lejon që të sigurojë që rekomandimet e tij të merren në konsideratë siç duhet dhe plotësisht nga Misioni dhe se ato zbatohen në masën më të madhe të mundshme.

3.2. Vendimet për meritat

Paneli dha katër (4) vendime rreth meritave gjatë vitit 2019.

Seanca e Panelit e 19-20 qershor 2019

- Lënda 2017-02 Zufe Miladinović kundër EULEX-it. Më 19 qershor 2019, Paneli ka vendosur që EULEX-i nuk kishte kryer ndonjë hetim efektiv rreth zhdukjes së anëtarit të familjes së ankueses dhe nuk e kishte informuar ankuesen. Si rezultat, Paneli ka vendosur që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në bazë të pjesës procedurale të së drejtës së ankesës për jetë, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për një shkelje të së drejtës së ankueses për mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor ose poshtëruar, siç garantohet me nenin 3 të

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i nxisë autoriteteve kompetente që të sigurojnë se hetimi penal rreth zhdukjes së anëtarit të familjes së ankuesit të vazhdojë në përputhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Seanca e Panelit e 10-12 shtatoe 2019

- Lënda 2016-28 S.H. kundër EULEX-it. Më 11 shtator 2019, Paneli vendosi që EULEX-i nuk kishte kryer ndonjë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të familjes së ankuesit dhe nuk kishte arritur ta mbante ankuesin të informuar. Më 11 dhjetor 2019, Paneli ka përcaktuar që EULEX-i nuk kishte kryer hetim efektiv rreth zhdukjes së anëtarit të familjes së ankuesit dhe nuk kishte arritur ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli ka përcaktuar që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje sipas pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, siç garantohet nga neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkelje të së drejtës së ankuesit për t'u mbrojtur nga trajtimi çnjerëzimi ose poshtëruës, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i ka dhënë rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, përfshirë t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për ta hetuar këtë lëndë, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe për t'u informuar rreth rrjedhës së përgjithshme të hetimit.

Seanca e Panelit të 11-13 dhjetorit 2019

- Lënda 2016-09 Milorad Trifunović kundër EULEX-it. Më 11 dhjetor 2019, Paneli ka përcaktuar që EULEX-i nuk kishte kryer hetim efektiv rreth zhdukjes së anëtarit të familjes së ankuesit dhe nuk kishte arritur ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli ka përcaktuar që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje sipas pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, siç garantohet nga neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkelje të së drejtës së ankuesit për t'u mbrojtur nga trajtimi çnjerëzimi ose poshtëruës, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i ka dhënë rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për ta hetuar këtë lëndë, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe për t'u informuar rreth rrjedhës së përgjithshme të hetimit.
- Lënda 2016-14 Milan Ađančić kundër EULEX-it. Më 11 dhjetor 2019, Paneli ka përcaktuar që EULEX-i nuk kishte kryer hetim efektiv rreth zhdukjes së një anëtari të familjes së ankuesit dhe nuk kishte arritur ta mbante ankuesin të informuar. Si rezultat, Paneli ka përcaktuar se Misioni ishte përgjegjës për një shkelje sipas pjesës procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkelje të së drejtës së ankuesit për mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i ka bërë disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për ta hetuar këtë lëndë, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe për t'u informuar rreth rrjedhës së përgjithshme të hetimit.

3.3. Vendimet e pranueshmërisë

Paneli dha trembëdhjetë (13) vendime mbi pranueshmërinë në vitin 2019.

Seanca e Panelit të 14-16 janar 2019

Paneli shpalli një (1) ankesë të papranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2018-02 D.W. kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me pretendime ndaj Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës. Paneli e shpalli këtë ankesë të papranueshme, sepse ngjarjet për të cilat u ankua nuk i ngarkoheshin EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv, dhe për rrjedhojë nuk kanë hyrë në kuadër të juridiksionit të Panelit.

Seanca e Panelit e 27-29 mars 2019

Paneli shpalli një (1) ankesë të papranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2018-04 Afrim Islami kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me një kërkesë që EULEX-i ta mbikëqyrte ndjekjen penale ndaj ankuesit. Paneli e shpalli këtë ankesë të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Paneli shpalli dy (2) ankesa të pranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2016-28 S.H. kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.
- Lënda 2017-02 Zufe Miladinović kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.

Seanca e Panelit e 19-20 qershorit 2019

Paneli shpalli një (1) ankesë të papranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2018-03 E.V. kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me kthimin në posedim të një prone familjare pas konfliktit në Kosovë. Paneli ka shpallur këtë ankesë të papranueshme sepse binte jashtë kuadrit të juridiksionit të Panelit dhe ishte qartazi e pabazuar.

Paneli shpalli tri (3) ankesa të pranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2016-09 Milorad Trifunović kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes të ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.
- Lënda 2016-10 Dragiša Kostići kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.
- Lënda 2016-14 Milan Ađančić kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.

Seanca e Panelit të 10-12 shtator 2019

Paneli shpalli katër (4) ankesa të pranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2016-11 Anđelija Brakus kundër EULEX. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.
- Lënda 2016-12 U.F. kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth bazueshmërisë së ankesave.
- Lënda 2016-13 Miomir Krivokapić kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e një anëtari të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.
- Lënda 2016-15 Dragan Janačković kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e anëtarit të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.

Seanca e Panelit të 11-13 dhjetor 2019

Paneli shpalli një (1) ankesë të pranueshme gjatë kësaj seance.

- Lënda 2016-17 Milijana Avramović kundër EULEX-it. Ankesa kishte të bënte me zhdukjen e anëtarit të familjes së ankuesit dhe hetimin rreth kësaj zhdukje. Paneli i shpalli ankesat të pranueshme dhe ftoi palët që të bëjnë parashtresa rreth meritave të ankesave.

3.4. Vendimet pasuese

Paneli shpalli katër (4) vendime pasuese gjatë vitit 2019.

Seanca e Panelit të 27-29 mars 2019

- Lënda 2011-20 X. dhe 115 të tjerë kundër EULEX-it. Me vendimin e datës 22 prill 2015, Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesve për një mjet juridik efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli kishte bërë disa rekomandime shifes së Misionit.
Më 11 nëntor 2015 dhe përsëri më 10 janar 2017, Paneli ka përcjellë zbatimin e rekomandimeve të tij.
Me datën 27 mars 2019, Paneli ka miratuar vendimin e tretë mbi zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Në atë vendim, Paneli thekson që ankuesve ende pritet që t'ju ofrohen mjete të përshtatshëm juridike dhe dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të tyre dhe fton EULEX-in që të vazhdojë kryerjen e mandatit të tij me qëllim që të sigurojë se të drejtat e ankuesve janë të plotësuara plotësisht.
Çështja në Panel mbetet ende në pritje.

Seanca e Panelit e 19-20 marsit 2019

- Lënda 2011-27 F. dhe të tjerët kundër EULEX-it. Me vendimin e datës 5 dhjetor 2017, Paneli konsideron se EULEX-i nuk ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtës së ankuesve për jetë në pjesën substanciale të tij, mirëpo ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesve sipas pjesës procedurale të së drejtës për jetë, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përveç kësaj, Paneli ka vendosur që EULEX-i ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtës së ankuesve për mbrojtjen nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i ka bërë dy rekomandime shifes së Misionit të EULEX-it.

Më 19 qershor 2019, Paneli ka nxjerrë vendimin pasues mbi zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Në këtë vendim, Paneli ka theksuar që shefja e Misionit kishte zbatuar plotësisht rekomandimin e parë të Panelit. Lidhur me rekomandimin e tij të dytë, Paneli ka theksuar se megjithëse shefja e Misionit nuk e kishte pranuar zyrtarisht përgjegjësinë e Misionit për shkeljen e të drejtave të ankueses, shefja e Misionit kishte ndërmarrë hapin e vlefshëm për t'i shprehur keqardhjen më të thellë ankueses në emër të Misionit.

Paneli ka vendosur të mbyllë shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj lënde.

Seanca e Panelit e 11-13 dhjetorit 2019

- Lënda 2011-20 X. dhe 115 të tjerë kundër EULEX-it. Me vendimin e datës 22 prill 2015, Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesve për një mjet juridik efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli kishte bërë disa rekomandime shifes së Misionit. Më 11 nëntor 2015 dhe përsëri më 10 janar 2017, Paneli ka përcjellë zbatimin e rekomandimeve të tij.

Me datën 11 dhjetor 2019, Paneli ka marrë vendimin e katërt lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Në vendimin e tij, Paneli vuri në dukje se ankuesve ende nuk iu janë ofruar mjete efektive juridike dhe dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të tyre, dhe ka ftuar EULEX-in që të bëjë një rishikim të plotë të mjeteve në dispozicion të Misionit për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të ankuesve në mënyrë efektive dhe të raportoj në Panel në lidhje me masat që propozon të marrë për ta bërë këtë. Paneli gjithashtu ftoi Misionin të shqyrtoj që t'i kontaktoj Shtetet Anëtare përmes Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm lidhur me mundësinë e dëmshpërblimit ose kompensimit për shkeljen e të drejtave të ankuesve që i janë atribuar Misionit nga Paneli.

- Lënda 2017-02 Zufe Miladinović kundër EULEX-it. Me vendimin e datës 19 qershor 2019, Paneli ka vendosur që EULEX-i nuk kishte kryer ndonjë hetim efektiv rreth zhdukjes së anëtarit të familjes së ankueses dhe nuk e kishte informuar ankuesen në lidhje me shkeljen e të drejtave themelore të ankueses. Si rezultat, Paneli ka vendosur që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në bazë të pjesës procedurale të së drejtës së ankueses për jetë, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për një shkelje të së drejtës së ankueses për mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me datën 11 dhjetor 2019, Paneli ka nxjerrë një vendim pasues në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Në vendimin e tij, Paneli vuri në dukje se të drejtat e ankuesit në lëndën në fjalë ende po shkelen, pasi rasti i të afërmeve të saj të zhdukur ende mbetet i pa hetuar. Paneli ka konsideruar që hapat e ndërmarra ose të propozuara deri më tani nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk japin përgjigje të duhura ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Si pasojë, Paneli konsideron që Misioni ende duhet të hulumtoj me kujdes se çfarë mundësish ekzistojnë për të

siguruar që shkelja e të drejtave të ankuesit të korrigojohet dhe të merr fund shkelja e tyre. Paneli e ftoi Misionin që të shqyrtojë me kujdes se çfarë mundësish ekzistojnë për Misionin për të kontribuar në këtë qëllim në një mënyrë kuptimplote dhe efektive, dhe të informojë Panelin për rezultatin e këtyre konsideratave dhe cilat masa Misioni propozon t'i ndërmerret për të arritur atë qëllim.

Paneli vendosi që të mbajë këtë lëndë të hapur për përcjellje të mëtejshme të mundshme.

4. Aktivitetet e tjera të Panelit

4.1. Takimet

Më 11 Janar 2019, Paneli është vizituar nga znj. Alexandra Papadopoulou, ish shefe e Misionit të EULEX-it Kosovë, e shoqëruar nga përfaqësues të Zyrës Ligjore dhe të Drejta të Njeriut, dhe një këshilltar i politikave i shefit të Misionit. Paneli diskutoi me shefin e Misionit një numër pyetjesh administrative, duke përfshirë procesin e përzgjedhjes për një anëtar të ri të jashtëm të Panelit. Në mënyrë të veçantë, Paneli kërkoi informata specifike në lidhje me njëzet e një (21) rastet në pritje të zhdukjeve me forcë që iu komunikuan shefit të Misionit në fillim të 2018 dhe këmbënguli për rëndësinë e këtyre rasteve për reputacionin dhe trashëgiminë e Misionit.

Më 10 shtator 2019, Paneli u takua me Zyrën Ligjore dhe të Drejta të Njeriut (ZLDNJ) të EULEX-it Kosovë për të diskutuar mënyrat për adresimin dhe zvogëlimin e vonesave në përpunimin e rasteve të komunikuar të zhdukjeve me forcë.

4.2. Fushata informuese e vitit 2019

Dokumenti i Konceptit të Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009, *ndër të tjera* në paragrafin E thekson se "... EULEX-i Kosovë do të sigurojë shpërndarje të duhur të informacionit publik rreth Panelit dhe punës së tij ...".

Komandanti i Operacioneve Civile, në udhëzimin e tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin, ka deklaruar se Udhërrëfyesi për Kapacitetet e Planifikimit dhe Operacioneve Civile duhet të përfshijë "... përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënies me publikun".

Sekretariati së bashku me një anëtar të Panelit zhvilluan një takim në vitin 2019, me z. Bexhet Shalën, drejtor ekzekutiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMLDNJ), një OJQ vendore me një histori të gjatë në mbrojtjen dhe promovimi e të drejtave të njeriut. Delegacioni i Panelit prezantoi punën e Panelit dhe ndryshimet si rezultat i mandatit të ri të EULEX-it Kosovë.

4.3. Trajnimi hyrës

Sekretariati ka vazhduar pjesëmarrjen e tij në programin e trainimit hyrës të EULEX-it për anëtarët e ardhshëm të stafit të EULEX-it. Formatit përbëhet nga një prezantim mbi punën e Panelit, me një pjesë të caktuar për pyetje dhe përgjigje. Ky proces është i dobishëm për t'i njoftuar anëtarët e ardhshëm të stafit rreth mandatit të Panelit, për të nënvizuar më tej rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për EULEX-in Kosovë dhe për të ngritur profilin e Panelit tek anëtarët e stafit të EULEX-it në fushën e operacioneve të EULEX-it Kosovë. Ky është një element i rëndësishëm në procesin që të sigurohet se stafi i Misionit të ndërgjegjësohet rreth detyrimeve të tyre ndaj të drejtave të njeriut dhe të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me të.

4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së

Sekretariati e mirëmban faqen e internetit të Panelit: www.hrrp.eu. Kjo faqe përmban informata lidhur me mandatin, procedurat dhe punën e Panelit, si dhe informata rregullisht të përditësuara lidhur me vendimet e Panelit, si dhe listën e lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe ato të përfunduara.

Aty ofrohet qasje e lehtë në tabelën e jurisprudencës së Panelit. Aty paraqitet praktika gjyqësore në rritje e sipër e Panelit sipas çështjes së lëndëve, si në bazë të pranueshmërisë dhe përmbajtjes së rasteve që janë në shqyrtim. Ajo është krijuar, mes tjerash, për të siguruar qasje të gatshme dhe të lehtë në praktikën gjyqësore të Panelit për ankuesit, juristët dhe për opinionin e gjerë: (<http://www.hrrp.eu/jurisprudence.php>).

Paneli gjithashtu ka prodhuar disa “Shënime të jurisprudencës” që përmbledhin sipas temave disa nga aspektet më të rëndësishme të jurisprudencës së tij (http://hrrp.eu/Case-Law_Notes.php).

Faqja e internetit gjithashtu ofron informacione për:

Standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut: (<http://www.hrrp.eu/relevant-rights.php>);

Formularët dhe udhëzimet për parashtrimin e ankesave: (<http://hrrp.eu/filing%20complaints.php>);

Po ashtu, Paneli e ka profilin e tij në Facebook: Human Rights Review Panel;

Informatat e mësipërme janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

5. Paneli dhe Sekretariati

5.1. Anëtarët e Panelit

Sipas Konceptit të Llogaridhënies dhe Rregullores së Punës së Panelit, Paneli përbëhet prej katër anëtarëve; dy anëtarë të jashtëm dhe dy anëtarë të EULEX-it, prej të cilëve njëri është zëvendës i tjetrit. Para rishikimit të mandatit në qershor të vitit 2018, dy anëtarët e EULEX-it ishin anëtarë të personelit të EULEX-it të emëruar për të punuar si gjykatës në sistemin gjyqësor të Kosovës. Pas rishikimit të mandatit, dy anëtarët e EULEX-it janë anëtarë të personelit të Shtyllës së Monitorimit të EULEX-it.

Pas dorëheqjes në dhjetor të vitit 2018 të një prej dy anëtarëve të jashtëm të Panelit, u krye një proces seleksionimi për të identifikuar një anëtar i ri i jashtëm i Panelit. Ky proces përfundoi në 26 qershor 2019 me përzgjedhjen dhe emërimin e znj. Anna Autio.

5.1.1. Kryesuesi i Panelit

Në pajtim me Planin Operacional të EULEX-it dhe Rregulloren e Punës së Panelit, një prej anëtarëve të jashtëm të Panelit zgjidhet kryesues. Deri në dorëheqjen e saj më 13 dhjetor 2018, Znj. Magda Mierzewska ka qenë në pozitën e kryesueses. Pas dorëheqjes së saj, anëtari tjetër i jashtëm, Prof. Dr. Guénaél Mettraux, është bërë ushtrues detyre i kryesuesit të Panelit.

Më 11 Shtator 2019, në seancën e parë të Panelit në përbërjen e tij të plotë, Dr. Mettraux u zgjodh zyrtarisht kryesues i Panelit nga i gjithë Paneli.

5.1.2. Anëtarët deri më 31 dhjetor 2019

Prof. Dr. Guénaél Mettraux – anëtar i jashtëm, kryesues i Panelit

Dr. Mettraux posedon *licence en droit* nga Universiteti i Lozanës (Zvicër), ka magjistruar në juridik në Kolegjin Universitar në Londër dhe ka doktoruar në London School of Economics and Political Science (Shkollën londineze të ekonomisë dhe shkencave politike).

Dr. Mettraux punon avokat dhe konsulent pranë gjykatave penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale.

Dr. Mettraux aktualisht është profesor bashkëpunëtor i së Drejtës Ndërkombëtare Penale në Dickinson Law School, Universiteti PennState, profesor i së drejtës në Science Po Paris, dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Fribourg-ut (Zvicër).

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare. Veprat e tij shkencore përfshijnë tre libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals (Krimet ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc)* (Shtëpia botuese Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial* (Perspektivat në gjykimin në Nuremberg) (Shtëpia botuese Oxford University Press, 2008), dhe *The Law of Command Responsibility* (Ligji i përgjegjësisë komanduese) (Shtëpia botuese Oxford University Press, 2009), e cila kishte fituar çmimin Lieber nga Shoqata amerikane e së Drejtës ndërkombëtare. Dr. Mettraux është anëtar i komisionit të redaksisë së revistës së të Drejtës penale ndërkombëtar dhe anëtar i këshillit të redaktorëve të *International Criminal Law Review* (Revistës të së Drejtës penale ndërkombëtarer).

Dr. Mettraux ka shërbyer si anëtar i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut që nga 30 shtatori 2012.

Znj. Anna Bednarek – Anëtare e EULEX-it, e emëruar më 19 dhjetor 2018.

Znj. Bednarek u emërua anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it (Paneli) nga shefi i Misionit të EULEX-it më 25 maj 2011, ndërsa u emërua anëtare e Panelit nga shefi i Misionit të EULEX-it më 12 korrik 2011. Ky emërim përfundoi në dhjetor 2011, por pas emërimit në shtator 2015, znj. Bednarek u bë përsëri anëtare e PShDNJ-së deri më 14 qershor 2018 kur u bë rishikimi i mandatit të EULEX-it Kosovë. Pas mandatit të rishikuar të EULEX-it Kosovë në qershor 2018, znj. Bednarek u emërua anëtare e Panelit nga shefi i Misionit të EULEX-it më 19 dhjetor 2018.

Znj. Bednarek ishte emëruar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Varshavë në qershor 1998. Gjatë karrierës së saj ajo ka punuar si eksperte e lartë në zyrën e agjentit të qeverisë polake në Komisionin Evropian dhe Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, të Drejtat e Njeriut dhe Divizioni i Minoriteteve Kombëtare, Departamenti Ligjor dhe i Traktatit të Ministrisë Polake të Punëve të Jashtme të Polonisë, Varshavë, si dhe Konsulli në Ambasadën Polake, Romë, Itali.

Për më tepër, ajo u emërua nga EULEX-i: Gjykatëse në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ku ka shërbyer që nga janari 2009 dhe nga shtatori 2015 gjykatëse në Kolegjin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP KA) në Gjykatën Supreme të Kosovës. Aktualisht, ajo mban pozitën e vëzhgueses tematike për Panelin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës së Gjykatës Supreme të Kosovës.

Z. Petko Petkov – Anëtar zëvendësues i EULEX-it, i emëruar më 19 dhjetor 2018.

Z. Petko Petkov ka diplomuar në Universitetin e Sofjes me titullin magjistër i juridikut. Ai ka shërbyer gjykatës i ri në Gjykatën e Rrethit të Sofjes nga viti 2005 deri në vitin 2007 dhe që nga viti 2007 është gjykatës në Divizionin Penal në Gjykatën Rajonale të Sofjes. Gjatë karrierës së tij si gjykatës penal ka punuar në mijëra raste dhe thelbi i punës së tij ka qenë që t'iu përmbahet gjithmonë parimeve të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga viti 2014 deri në vitin 2015 ai u emërua ekspert për zëvendësministrin e Drejtësisë të Republikës së Bullgarisë. Gjatë kësaj periudhe ai ishte përgjegjës për përfaqësimin e vendit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe duhej të ofronte udhëzime metodologjike dhe kontroll mbi veprimtarinë e Drejtorisë brenda Ministrisë. Përveç detyrave që kanë të bëjnë me përcaktimin e mënyrës së veprimit *modus operandi* të përfaqësimit procedural para GJEDNJ-së, ai ishte i përfshirë drejtpërdrejt në hartimin e ndryshimeve legjislative në lidhje me gjyqësorin.

Prej vitit 2012 deri në vitin 2015 ka qenë ligjërues musafir rreth të Drejtës Penale në Institutin Kombëtar të Trajnimit për Gjyqësorin, ku ka zgjeruar dhe zhvilluar njohuritë e tij në një nivel më teorik dhe akademik.

Ai iu bashkua EULEX-it Kosovë në vitin 2017 si gjykatës penal ndërkombëtar, ku ka punuar deri në fund të mandatit ekzekutiv të Misionit në vitin 2018. Aktualisht është vëzhgues tematik në fushën e krimeve sipas ligjit ndërkombëtar në EULEX.

Z. Petkov është emëruar anëtar zëvendësues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefja e Misionit të EULEX-it Kosovë më 19 dhjetor 2018.

Znj. Anna Autio – Anëtare e jashtme, e emëruar më 26 qershor 2019.

Anna Autio ka diplomuar në Universitetin e Oksfordit. Po ashtu ka diplomuar në fakultetin juridik në Universitetin e Sidneit, posedon një Certifikatë *de droit transnational* nga Universiteti i Gjenevës, një Diplomë e praktikës ligjore nga Kolegji i Juridikut, Australi, dhe magjistraturë nga King's College në Londër. Ajo ishte pranuar juriste në Gjykatën Supreme të Uellsit të Ri Jugor, Australi, në vitin 2007.

Znj. Autio ka përvojë të gjerë duke punuar në të drejtën ndërkombëtare dhe programet e të drejtave të njeriut, veçanërisht në mjediset në konflikt, pas konfliktit dhe në mjediset e tranzicionit. Temat e punës së saj rreth të drejtave të njeriut përfshijnë të drejtat civile dhe politike, sundimin e ligjit dhe qasjen në drejtësi, si dhe të drejtat e viktimave të konflikteve të armatosura, grave, fëmijëve, popujve autokton, pakicave dhe grupeve të tjera të ndjeshme.

Znj. Autio ka punuar për Bankën Botërore në Uashington DC, duke udhëhequr fondin e saj për të drejtat e njeriut dhe krijimin e një Fondi të ri për të Drejtat e Njeriut dhe Zhvillim të Mirëbesimit, duke ofruar këshilla teknike dhe trajnime për të drejtat e njeriut. Ajo gjithashtu ka punuar për UNESCO në Marok dhe Tunizi, duke e udhëhequr organizatën e zyrës së Tunizit dhe mbështetur qeverinë tuniziane, autoritetet kushtetuese dhe shoqërinë civile në fushat e lirisë së shprehjes, gjinisë dhe reformës së sektorit të sigurisë dhe duke bashkërenduar projektet rajonale të lirisë së shprehjes në Egjipt, Libi, Marok, Siri, Tunizi dhe Jemen. Znj. Autio gjithashtu ka punuar zyrtare ligjore për UNEP në Gjenevë dhe avokate e përqendruar në të drejtën ndërkombëtare publike dhe të drejtën e Bashkimit Evropian në firmat ligjore ndërkombëtare në Bruksel.

Shefja e Misionit të EULEX-it e ka emëruar znj. Autio anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 26 qershor 2019.

5.2. Sekretariati

Sekretariati i Panelit përbëhet nga një zyrtar ligjor dhe dy përkthyes/Interpret. Sekretariati ndodhet në ambiente të dedikuara ku gjenden administrata, regjistrat dhe arkivat e tij, jashtë vendndodhjes së EULEX-it Kosovë.

6. Çështjet operative dhe administrative

6.1. Buxheti

Në vitin 2019, Paneli nuk ka pasur buxhet të vet, ndaras nga ai i Misionit. Më herët, buxheti i veçantë i mundësoi Panelit që të marrë vendimet e veta për zbatimin e fushatës për informim publik, në veçanti për transmetimet televizive dhe/ose radio, pa u mbështetur në burimet buxhetore të Zyrës së Shtypit dhe Informimit Publik të EULEX-it Kosovë.

6.2. Burimet njerëzore

Stafi i Sekretariatit të Panelit ka mbetur i njëjtë përgjatë vitit 2019.

7. Konkluzionet dhe rekomandimet

7.1. Pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i

Sic u tha në raportet e mëparshme, Paneli rekomandon edhe një herë se shefi i Misionit duhet të konsiderojë njohjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, të cilat Paneli ka gjetur se i atribuohen EULEX-it. Një njohje e tillë publike nga Misioni do të ishte një pjesë thelbësore e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut në bazë të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP dhe do të shkonte në një farë mënyre drejt korrigjimit të shkeljeve të identifikuara nga Paneli.

Bazuar në sa më sipër, Paneli fton edhe njëherë shefin e Misionit, në konsultim me autoritetet përkatëse, që të konsiderojë seriozisht rëndësinë dhe implikimet e njohjes sistematike të përgjegjësive të Misionit në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhe të konsiderojë një ndryshim të praktikës në këtë drejtim.

7.2. Programi i reparacionit

Pagesa e kompensimit ose dëmshpërblimi për ankuesit dhe anëtarët e familjes në fjalë është një temë e vazhdueshme në domenin publik në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë. Fakti që ankesa vërtetohet me konstatimin e shkeljes së të drejtave të njeriut mund të mos paraqesë mjet efektiv juridik të plotë ose adekuat për shkeljet në fjalë.

Prandaj, rekomandohet që kur konstatohet se Misioni ka kryer shkelje të të drejtave të njeriut, Misioni duhet të konsiderojë seriozisht mundësinë e ofrimit të dëmshpërblimit adekuat, përfshirë kompensimin financiar, kur është e përshtatshme.

Ky sugjerim është bërë tashmë nga Paneli në Raportin Vjetor të tij të vitit 2018. Paneli vëren me keqardhje që sugjerimi i tij mbetet i paplotësuar.

Në të vërtetë, gjetjet dhe rekomandimet e Panelit përbëjnë formën e vetme lehtësuese në rastet që përfshijnë shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen Misionit së bashku me zbatimin e këtyre rekomandimeve të shefit të Misionit. Në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut me ndonjë peshë, siç janë rastet e zhdukjes me forcë (shih në vijim), një lehtësim i tillë mund të thuhet se është plotësisht i papërshtatshëm.

Prandaj, Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mënyrat e tjera me të cilat Misioni mund të korrigjojë shkeljen e të drejtave të atyre për të cilët Paneli ka thënë se ishin prekur nga veprimi i tij. Është thelbësore që një reflektim i tillë të ndodhë ndërsa Misioni është akoma aktiv në mënyrë që mbyllja e tij të mos mund të shërbejë si një fakt i kryer që do t'i sinjalizonte viktimat se shkelja e të drejtave të tyre do të mbetet pa ndonjë mjet efektiv juridik.

7.3. Rastet e personave të zhdukur

Rastet e zhdukjes me forcë përbëjnë shumicën e çështjeve në pritje të Panelit. Secila prej këtyre rasteve përmban veçori individuale që pasqyrojnë veçantinë e çështjes. Sidoqoftë, këto raste pasqyrojnë gjithashtu probleme sistemike që kanë ndikuar në Mision në të kaluarën.

Në veçanti, këto ankesa sugjerojnë që Misioni nuk arriti të përcaktojë përparësitë e rasteve që duhet të kishin marrë vëmendje të konsiderueshme nga Misioni. Përsa përfaqësojnë këto raste, pasojat e këtyre mbi të drejtat e të zhdukurve dhe të afërmeve të tyre të mbijetuar si dhe rëndësia shoqërore e këtyre rasteve në një kontekst pas konfliktit ishin të gjithë faktorë që kërkuan vëmendjen e Misionit dhe e bënë gjënë më të rëndësishme hetimin efektiv të rasteve.

Fatkeqësisht shumë dhe ndoshta shumica e këtyre rasteve mbeten të pa hetuara ose të hetuara jo si duhet. Të afërmit që mbijetuan në shumë raste nuk kontaktohen nga Misioni ose iu ofrohen informata jo adekuate për sa i përket statusit të lëndës, nëse ekzistonte.

Dosjet që kishin të bënin me këto raste mbaheshin në vende të ndryshme, jo gjithmonë të ndara midis organeve të ndryshme të Misionit dhe shpesh ishin mbyllur përpara se të ishte kryer një hetim i duhur. Bashkërendimi me akterë të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë duket gjithashtu se ka qenë i pamjaftueshëm në disa raste.

Kjo është veçanërisht për të ardhur keq për rastin e një Misioni të krijuar për të promovuar sundimin e ligjit dhe i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nëse këto lëndë nuk adresohen siç duhet, këto mangësi ka të ngjarë të njollosin reputacionin dhe trashëgiminë e Misionit.

Prandaj, Paneli i bën thirrje shefit të Misionit, vetë Misionit, shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të treta kontribuese, si dhe palëve të tjera të interesuara, të punojnë së bashku për gjetjen e një zgjidhjeje për shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të njeriut në rastet e zhdukjes së detyruar. Këto raste nuk duhet dhe nuk mund të lejohen të mbeten të pahetuara. Ato janë të rëndësishme, jo vetëm për të afërmit që kanë mbijetuar, por edhe për vetë Kosovën, e cila duhet të përballet me të kaluarën, sado e dhimbshme.

Paneli do të mbetet plotësisht i angazhuar që pjesa e mbetur e mandatit të tij të luaj rolin në përpjekjen për të gjetur një zgjidhje për situatën aktuale dhe të kërkoj të adresoj shkeljet e të drejtave themelore të njeriut që janë të lidhura me këtë situatë që po vazhdon.

7.4. Fundi i Misionit dhe të drejtat e njeriut

Përveç çështjeve specifike të përmendura në këtë pjesë, Paneli fton Misionin të reflektojë në mënyrat me të cilat mund të sigurohet që pjesa e mbetur e mandatit të tij të kryhet në një mënyrë në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtat e njeriut. Ai gjithashtu fton Misionin të reflektojë se si mund të ndihmojë në promovimin e një kulture respekti për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut në Kosovë, në mënyrë që trashëgimia e tij të perceptohet nga një këndvështrim pozitiv. Paneli mbetet i përkushtuar të ndihmojë në një proces të tillë.

SHTOJCA 1 Statistikat 2010 – 2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Gjithsej
Lëndët e regjistruara - gjithsej	16	28	23	27	42	16	35	7	4	2	200
Lëndët e përfunduara - gjithsej	6	30	10	20	28	27	19	25	6	4	175
E pranueshme	0	7	2	7	2	21	2	2	0	10	53
E papranueshme	6	22	10	13	21	12	9	23	6	3	125
Shkelje	0	2	0	7	2	4	9	2	0	4	30
Nuk ka shkelje	0	5	0	0	1	10	0	0	0	0	16
Të hequra nga lista	0	1	0	0	3	1	1	2	0	0	8

	Deri më 15 dhjetor 2019
Lëndët e papërfunduara	25
Të komunikuar te ShM-ja	24

SHTOJCA 2**Vendimet e Panelit 2010-2019**

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2010-01	Djeljalj Kazagić	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2010-02	Sadik Thaqi	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, dekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-03	Osman Mehmetaj	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-04	Feti Demolli	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-05	Mursel Hasani	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-06	Latif Fanaj	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-07	Blerim Rudi	Pretendim për moszbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare	Shkelje
2010-08	Delimir Krstić	Pretendim për mosveprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore	E papranueshme
2010-09	Burim Ramadani	Pretendim për mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-13	Një punonjës i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme
2010-14	Lulzim Gashi	Kandidim i pasuksesshëm në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2010-15	Faton Sefa	Mos rikthim në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), pretendim për mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme
2010-16	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i lëndës së ankueses në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
2011-01	Familjae Dedë Gecaj	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme
2011-02	Chamalagai Krishna Bahadur	Pretendim për mosveprim	E papranueshme
2011-03	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
2011-04	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista
2011-05	SH.P.K "Syri"	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhPGjS	E papranueshme
2011-06	Milazim Blakqori	Pretendim për moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it	E papranueshme
2011-07	Lënda W	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
2011-08	Anton Rruka	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhPGjS	E papranueshme
2011-09	Mirkovic Bojan	Pretendim për largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
2011-10	Dejan Jovanović	Pretendim për vones të panevojshme gjatë procedurave në DhPGjS	E papranueshme
2011-11	Srecko Martinović	Pretendim për përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2011-12	Novica Trajković	Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës	E papranueshme
2011-13	S.M.	Pretendim për përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2011-14	Lindita Shabani	Pretendim për mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshme
2011-15	Samedin Smajli	Pretendim për mohim të gjyqimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
2011-16	Avdyl Smajli	Pretendim për mohim të gjyqimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
2011-17	Faik Azemi	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2011-18	Mykereme Hoxha	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme
2011-19	Sefer Sharku	Pretendim për mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor	E papranueshme
2011-20	X dhe 115 ankuesit e tjerë	Pretendim për mosveprim nga EULEX për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së personave që kanë jetuar në kampet rome të kontaminuara me plumb.	Shkelje
2011-21	Ventor Maznikolli	Pretendim për vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme	E papranueshme
2011-22	Hysni Gashi	Pretendim për mohim të një gjykimi të drejtë dhe pretendim për paaftësi të gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
2011-23	Hashim Rexhepi	Pretendim për shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
2011-24	Predrag Lazić	Pretendim për mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm	E papranueshme
2011-25	Shaip Gashi	Pretendim për privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi	E papranueshme
2011-26	Njazi Asllani	Pretendim për mos zbatim të një vendimi, mosveprim nga EULEX-i	E papranueshme
2011-28	Lënda Y	Pretendim për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës	E papranueshme
2012-01	Qamil Hamiti	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2012-02	Arben Zeka	Pretendim për mos gjykim të një lënde pronësore	E papranueshme
2012-03	Rexhep Dobruna	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2012-04	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2012-05	Fatmir Pajaziti	Pretendim për shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë	E papranueshme
2012-06	Lënda Z	Pretendim për shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe nenit 6 të KKT-së	E papranueshme
2012-07	Lënda I	Pretendim për mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it	E papranueshme
2012-08	Lënda U	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-09	Lënda A	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-10	Lënda B	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-11	Lënda C	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-12	Lënda D	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-13	Bejtush Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-14	Valbone Zahiti	Pretendim për shkelje të nenit 8 të Konventës	Shkelje
2012-15	Shefqet Emerllahu	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mos hetim	E papranueshme
2012-16	Kristian Kahrs	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim	E papranueshme
2012-17	Lënda E	Pretendim për shkelje të neneve 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-18	Hamdi Sogojeva	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-19	Lënda H	Pretendim për konfiskim të pronës	Shkelje
2012-20	Lënda G	Pretendim për shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
2012-21	Mirko Krlić	Pretendim për shkelje të nenit 9 të KEDNj-së dhe nenit 2 të Protokollit 4 të KEDNj-së	Nuk ka shkelje
2012-22	Zoran Stanisić	Pretendim për shkelje të neneve 3, 6 dhe 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	Shkelje

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2012-23	Predrag Blagić	Pretendim për shkelje të nenit 5 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2013-01	Lënda I	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-02	Arsim Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-03	Goran Becić	Pretendim për shkelje të nenit 5 dhe 14 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
2013-04	J	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-05	Lënda K	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-06	Lënda L	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-07	Lënda M	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-08	Lënda N	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-09	Lënda O	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-10	Lënda P	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-11	Lënda Q	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-12	Lënda R	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-13	Lënda S	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-14	Lënda T	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-15	Gani Zeka	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-16	Almir Susaj	Pretendim për shkelje të nenit 3 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-17	Ramadan Rahmani	Pretendim për shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-18	Jovanka, Dragan, Milan Vuković	Pretendim për shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-19	U	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2013-20	Shaip Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-22	Gani Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-23	V	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-24	Emin Maxhuni	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-25	Milorad Rajović	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-26	Selami Taraku	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-27	Shaban Kadriu	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-01	Nexhat Qubreli	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-02	Milica Radunović	Pretendim për shkelje të nenit 3, 8 dhe 13 i KEDNj-së	E papranueshme
2014-03	Lënda A.Z.	Pretendim për shkelje të nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 të KEDNj-së, nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2014-04	Tomë Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-05	Mazlam Ibrahim	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
2014-06	Lënda B.Y.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-07	Fitore Rastelica	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-08	C.X.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-09	Rifat Kadribasic	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-11	Lënda D.W.	Pretendim për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës	E pranueshme
2014-18	Fitim Maksutaj	Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës	Shkelje
2014-19	Fahri Rexhepi	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-20	Mensur Fezaj	Pretendim për shkelje të nenit 1 të	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
		protokollit nr. 1 të KEDNj-së	
2014-21	Shefki Hyseni	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 KEDNj-së	E hequr nga lista
2014-22	Ismajl Krapi	Pretendim për shkelje të nenit 5 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-23	Shaip Selmani	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-24	Lënda J.Q.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës	E papranueshme
2014-25	Nuha Beka	Kontest punësimi	E papranueshme
2014-28	Selatin Fazliu	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
2014-26	Ajet Kaçi	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-27	Qerim Begolli	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-29	Shemsi Musa	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-30	Abdilj Sabani	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-31	Lënda K.P.	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-32	L.O.	Pretendim për shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2014-33	Arben Krasniqi	Pretendim për shkeljen e nenit 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-34	Rejhane Sadiku Syla	Pretendim për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës	E pranueshme
2014-36	Lënda Z.A.	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
2014-38	Slavica Mikic	Pretendim për shkelje të nenit 13 të Konventës	E papranueshme
2014-39	Musli Hyseni	Pretendim për shkelje të nenit 5 të Konventës	E hequr nga lista
2014-40	Avni Hajdari	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2014-41	Liridona Mustafa Sadiku	Pretendim për shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-42	Bujar Zherka	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2015-01	Milos Jokic	Pretendim për shkelje të neneve 5, 6, 8, 9, 10 dhe 12 të Konventës	E papranueshme
2015-03	Dekart Shkololli	Pretendim për shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-07	Dobrivoje Radovanovic	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-08	Afrim Berisha	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-09	Driton Hajdari	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-10	Shaban Syla	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-13	Lënda W.D.	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-03	Afrim Islami	Pretendim për shkelje të nenit 6, dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
2015-04	Nazmi Maloku	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-10	Nikole Sokoli	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3 dhe 13 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-04	Valon Jashari	Pretendim për shkelje të neneve 3, 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-02	V.E.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-01	Skender Jashari	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-15	Đorđe Šmigić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-12	U	Pretendim për shkelje të neneve 6, 13 dhe 14 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-11	Zvonimir Jovanović	Pretendim për shkelje të nenit 6, dhe nenit 1, Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-06	X.C.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-05	Teresa Peters	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-35	M.N.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-14	Miodrag Konić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2015-16	Vuleta Voštić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2015-02	Ramadan Hamza	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-03	Alfred Bobaj	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-36	Namon Statovci	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe neneve 9 dhe 11 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-33	Agron Bytyçi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-27	Afrim Islami	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-26	T.G.	Pretendim për shkelje të nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-25	Hilmi Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-08	Hamdi Hasani	Pretendim për shkelje të nenit 8, dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj- së	E papranueshme
2016-07	Mentor Qela	Pretendim për shkelje të nenit 3, 6 dhe 17 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-06 /2017-04	Shpresim Uka	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-05	Axhemi Zyhdi	Pretendim për shkelje të nenit 6, nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-21	Thomas Rusche	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj- së	Shkelje
2011-27	F. dhe të tjerët	Pretendim për mos mbrojtjetë dëshmitarit, e drejta për jetë	Shkelje
2016-34	R.I. kundër EULEX	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-35	Ndërmarrja Hoteliere Turistike Iliria Deçan kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-01	A.Z. kundër EULEX	Pretendim për shkelje të nenit 3, 6, 9 dhe 14 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-05	Hysni Gashi kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2017-06	Feriz Gashi kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-07	C.X kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
Vendimet 2019			
2011-20	X. dhe të tjerë kundër EULEX-it	Pretendohet për dështim nga ana e EULEX-it që të mbroj shëndetin dhe jetën e personave që jetojnë në zonën e kontaminuar me plumb në kampin e romëve.	Vendimi i tretë dhe i katërt pasues
2011-27	F. dhe të tjerë kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 të KEDNj-së	Vendim pasues
2018-02	D.W. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 të KEDNj-së	E papranueshme
2018-04	Afrim Islami kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2018-03	E.V. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 1 Protokollin nr. 1 i KEDNj-së	E papranueshme
2017-02	Zufe Miladinović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje dhe vendim pasues
2016-28	S.H. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-09	Milorad Trifunović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-14	Milan Ađančić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-10	Dragiša Kostić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-11	Anđelija Brakus kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-12	U.F. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-13	Miomir Krivokapić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-15	Dragan Janačković kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-17	Milijana Avramović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme